



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XII i botimit, nr. 126, prill 2014

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro



SHOQATA E VËLLAZËRISË  
KOSOVË-MALËSI E MADHE  
"MARTIN DRESHAJ"  
PEJË

me datën 25-26 Prill 2014  
në Rrafshin e Dukagjinit  
zhvillohet manifestimi

## "ZËRI I VËLLAZËRIMIT-2014"



SHOQATA  
ATDHETARE - DUKAGJINI  
SHKODËR

### Lazër Stani: Librin e parë nuk e kam lexuar, ma lexuan

BASHKËBISEDIM ME  
SHKRIMTARIN E PUBLICISTIN  
LAZER STANI

Cili është libri më i vjetër që keni  
në bibliotekën tuaj? Kur e keni  
blerë dhe cila ishte arsyeja?


Botimet më të vjetra që gjenden  
në shtëpinë time janë një koleksion  
i «Hyllit të Dritës» botime të  
gjysmës së parë të shekullit të kaluar.  
Një enciklopedi e tërë etnokulturore,  
gjuhësore filozofike, historike,  
sociologjike, religjioz...

3

### ZEF SHYTANI - Vendosë në dorë orën e Petrit Dumes

(kujtime)

Kisha dëgjuar prej disa kohësh se  
ka qenë një qitës shumë i mirë nga  
mesi i shekullit të kaluar nga Lotajt  
që quhej Zef. Nuk dija më shumë  
për të, prandaj dhe kisha dëshirë që  
ta takoja e ta njohja nga afër.



5

### Një ngjarje e veçante në fshatin Toplane!

Ka qene vjeshta e vitit 1943, kur  
një avion luftarak vinte nga Gjako-  
va në drejtim të Shkodrës, por një  
defekt në motor, detyroi pilotin të  
bënte një ulje të detyrueshme duke  
lëshuar avionin poshtë majës së  
madhe "Mbi Bota" dhe piloti të hid-  
het me parashute e të bie në mes të  
fshatit, afër kishës së Toplanës.

Pjeter Gera e Mark Marashi  
Kapaj, të cilët në atë kohe ishin rreth  
moshës 8-9 vjeçare, kujtojnë sot atë  
zhurme të madhe, e cila tronditi të  
gjithë fshatin. Menjëherë fshati u  
alarmua dhe të gjithë fshataret, siç  
ishin në punët e vjeshtës u drejtuan  
pranë vendit ku kishte ra avioni.  
Fshati mësoj se, piloti kishte zbritur  
me parashute afër Kodër-Zarit.

5



## GËZIMI I SHKODRËS

### Bashkëbisedim me Mjeshtrin e madh të humorit shqiptar, Gëzim Kruja

Gjatë punës sime për përgatitjen e një cikli artikujsh kushtuar personaliteteve  
të artit dhe kulturës shkodrane kryesisht në fushën e letërsisë, skenës dhe muzikës,  
një vend të veçantë do të zinte edhe figura e "Mjeshtrit të Madh", shkrimtarit dhe  
humoristit Gëzim Kruja.

Kjo figurë e shquar e galerisë së humorit shkodran radhitet në mënyrë dinji-  
toze edhe me pararendësit e tij, edhe me bashkëkohësit e tij, por e gjithë gama  
e veprimtarisë artistike e bën atë më specifik; ai nuk është një aktor si të tjerët  
"klasik i skenës", por është shumë dimensional me aftësi të gjithanshme.

10

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi  
Botimin:  
NDUE  
FTONI

